

**V E N D I M**  
**PER VENDOSJEN E SEKUESTROS PREVENTIVE**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane, e përbërë nga:

**GJYQTARE :        FATIME DEÇOLLI**

asistuar nga sekretare gjyqësore **Blerina ORUÇI**, sot më **date 12.03.2017**, mori në shqyrtim materialin procedues që i përket :

**KERKUES:**        Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përfaqësuar në gjykim nga **prokurorja Antoneta Sevdari**.

**OBJEKTI:**        Sekuestrimin e parave të ndodhura në llogaritë bankare të F. N. P. e datelindjes 02.06.19.., lindur në Shkoder dhe banuese në Tirane dhe vendosjen e sekuestros të llogarive pranë Bankes “Tirana Bank”, “Banka Kombëtare Tregtare”, Raiffeisen Bank” dhe “Alpha”.

**KUNDER:**        Personit nën hetim **F. P.**, e bija e N., dtl.02.06.19.., lindur në Shkoder e banuese në Tirane.

**I DYSHUAR:**    Për veprën penale të “Pastrim të produkteve të vepres penale apo veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

**BAZA LIGJORE:** Neni 36,210,274 i K.Pr.Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën në seance gjyqësore.Degjoi prokurorin që perfundimisht kerkoi nga gjykata pranimin e kerkeses se paraqitur sipas objektit;

## V Ë R E N:

Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane ka rregjistruar procedimin penal nr.1917/2017 per vepren penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale", te parashikuar nga neni 287 I Kodit Penal. Ky procedim penal eshte rregjistruar mbi bazen e materialit referues te derguar nga Drejtoria Vendore e Policise Tirane. Nga aktet e ndodhura ne kete procedim penal rezulton se:

Ne "TIRANA BANK", rezulton nje llogari bankare ne emer te shtetases F. N. P., e datelindjes 02.06.19.., lindur ne Shkoder dhe banuese ne Tirane, Rr. "...".

Nga informacionet e policise gjyqesore rezulton se kjo shtetase per periudhen Dhjetor 2011-Shkurt 2017 ka nje numer te konsiderueshem transaksionesh bankare, ne shifra te larta, per te cilen krijohen dyshime se vijne nga aktivitetet e paligjshme kriminale.

Shtetasja F. P. mban llogari prane bankes "Tirana" qe prej Gushtit 2011 dhe eshte mbajtese e disa mjeteve te identifikimit. Ne momentin e hapjes se llogarive kjo shtetase ka deklaruar si profesion infermiere.

Natyra e veprimeve eshte kryesisht e tipit derdhje ne llogari dhe vendosje ne depozite. Me konkretisht:

- Ne date 09.12.2011 i ka mberritur nje transferte me urdherues shtetasin D. H. per shitje makine ne vlere 20.000 euro.
- Me date 04.05.2012 eshte depozituar ne llogarine e saj shuma 20.000 euro me depozitues shtetasin D. H. i datelindjes 21.08.19.., per shitje pasurie ne Shkoder.
- Ne date 14.09.2012 ka vendosur ne depozite shumen 30.000 euro dhe ka terhequr shumen 10050 euro.
- Ne date 06.02.2013 eshte maturuar depozita dhe prej saj jane rivendosur ne depozite vetem 20.000 euro nderkohe shuma prej 10.144 euro eshte terhequr.
- Per periudhen Qershor - Nentor 2013 jane kryer 3 derdhje prej saj ne vlere totale 27 500 euro dhe nje pjese e se ciles i eshte shtuar depozites.
- Per periudhen Janar - Prill 2014 ka kryer 2 derdhje ne vlere totale 55 440 euro, te cilat i jane shtuar depozites se meparshme.
- Ne date 28.02.2017 jane mbyllur depozitat ne vlere – 6.134 euro, ne vlere 20.488 euro dhe 37.708 euro.
- Ne date 03.03.2017 ka kerkuar te transferoje shumen 75.000 euro ne Hollande me perfutues zyren e noterise atje, D... N... K..., per blerje apartamenti. Nga ana e saj eshte dorezuar nje kontrate shitblerje e nenshkruar ne Hollande sipas se ciles Shtetasja F. P. blen nga shtetasi L. R. C. N. nje apartament ne vlere 165.000 euro.

- Ne llogarine e saj ne monedhen paund ne date 14.08.2013 eshte depozituar shuma 6 000 paund, e cila eshte vendosur ne depozite me afat 1 vjecar.
- Gjendja aktuale e llogarive eshte 98.100 Euro, 119.100 leke dhe 6.074 paund.

Nga verifikimi i bere ne lidhje me familjaret e shtetases F. P. dhe shtetasin D. B. H., rezultoi se ka transaksione ne emer te shtetasve:

#### **A. C.:**

Ne date 03.12.2012 ka blere nga shtetasja M. Zh.nje apartament ne vlere 3950 000 leke. Menyra e pageses eshte deklaruar cash.Ne date 24.06.2011 eshte kredituar llogaria e perbashket qe kjo shtetase ka me F. P., ne Banken "Kornbetare Tregtare", ne vlere 1 800 000 leke, te vendosura ne depozite.Nga ALUIZNI rezulton se ka ne proces legalizimi nje pasuri me nr.prot. 350, nr.pasurie 3/608, zone kadastrale 8130, Tirane.

**F. P.:**Ne date 24.06.2011 ka terhequr nga llogaria ne Banken "Raiffeisen" shumen 1 800 000 leke, te cilen e ka depozituar me pas ne Banken "Kornbetare Tregtare" ne llogari te perbashket me A. C..

#### **D. H.:**

Ne date 23.04.2014 nga shtetasja M. H.eshte derdhur ne llogari ne Bankert "Tirana" shuma 10 000 euro nga kursime.

Ne date 31.03.2015 ka terhequr nga llogaria ne Banken "Tirana" shumen 10 000 euro;

Ne date 11.11.2015 ka derdhur ne Banken "Tirana" shumen 9 000 euro si te ardhura nga emigracioni.

Nga kerkimi ne QKR nuk rezultojne biznese ne emer te ketyre shtetasve.

#### **Nga verifikimet e bera ne sistemin TIMS ne lidhje me shtetasen F. N. P.rezultoi se:**

Kjo shtetase, ka kryer nje sere hyrje dalje nga RSH, ku per here te fundit ka dale nga RSH ne date 28.01.2017, ora 15:49 min, nga pika e kalimit kufitar Murriqan, me automjetin me targa A...D dhe ka hyre ne RSH ne daten 25.02.2017, ora 17:12min, nga e njejta pike kufitare dhe me te njejtin automjet. Ne te njejtat data dhe ore dhe me te njejtin automjet rezulton se ka levizur dhe shtetasi D. B. H. i datelindjes 21.08.19.., lindur dhe banues ne Shkoder. Udhetime te shpeshta, se bashku te ketyre shtetasve vihen re nga kqyrja e te dhenave te sistemit "Tims"

Nga verifikimi ne lidhje me shtetasen F. P., ne rubriken shenime te sistemit tims, rezulton se ne daten 04.02.2013, ora 17:29 min, eshte kthyer ne RSH ne kategorin "Deportuar".

Po ashtu nga verifikimi ne rubriken shenime ne sistemin *tims*, ne lidhje me shtetasin D. H., rezulton se ky shtetas eshte kthyer ne daten 24.10.2007, ora 16:55min ne PKK Kom Pol Rinas, me kategorin "Leje Kalimi" dhe eshte transferuar ne Drejtorin e Policise Tirane, prane zyres se Luftes Kunder Droges dhe Zyre se Kerkimit. Ne date 07.06.2004, figuron i shpallur ne kerkim nga Kom.Pol.Nr 1 Tirane pasi ne daten 02.09.2003,ky shtetas ka mar per qellime prostitucioni shtetasen F. P.. Ne daten 28.03.2004, eshte shpallur person ne kerkim, pasi me shkrese nr. 5142 date 29.03.2004, Prokuroria e Rrethit Tirane ka nxjerr urdher ndalimi, per vepren penale te "Trafikimit me qellim prostitucioni". Ne date 29.09.200, eshte ekzekutuar urdheri i prokurorise dhe eshte bere ndalimi I ketij personi.Nga shkresa nr 5250/1 date 10.12.2003, rezulton se ky person ka ndryshuar emrin nga L. ne D..

Ne keto kushte,organi procedures vlereson se ekzistojne dyshime te bazuara ne prova se shumia e parave te sipercituara te gjendura ne llogarine e shtetases F. P. ka si burim, veprimtari te paligjshme kriminale dhe krijon dyshime se transaksionet kryhen me qellim per te mbuluar gjurmet dhe per te shpetuar sekuestrimi dhe konfiskimit te ketyre parave si product te vepres penale.

Per kere arsye I eshte drejtuar gjykates me kerkesen me objektin e mesiperm te gjykimit,bazuar ne nenet 210, 274 te K.Pr.Penale dhe 36 te K.Penal.

### **Arsyetimi ligjor I gjykates.**

Ne shqyrtimin e kerkesave ,kjo gjykate iu referua ligji material dhe procedural penal,konkretisht parashikimeve ne dispozitat e meposhtme:

### **Nenin 274 i Kodit te Procedures Penale:**

#### **"Objekti i sekuestros preventive" :**

*"1.Kur ka rrezik qe disponimi i lire i nje sendi qe lidhet me vepren penale mund te rendoje ose te zgjase pasojat e saj ose te lehtësoje kryerjen e veprave penale te tjera, me kerkesen e prokurorit, gjykata kompetente urdheron sekuestrimin e tij me vendim te arsyetuar. 2.Sekuestroja mund te vendoset edhe per sendet, produktet e vepres penale dhe çdo lloj pasurie tjeter qe lejohet te konfiskohet, sipas nenit 36 te Kodit Penal".*

### **Neni 210 i Kodit te Procedures Penale**

#### **Sekuestrimi prane bankave**

*(Shtese ne piken 1 me ligjin nr.9085, date 19.6.2003)*

1.Gjykata mund te vendose sekuestrimin prane bankave te dokumenteve, letrave me vlere, shumave te depozituara ne llogari rrjedhese dhe cdo gjeje tjeter, edhe nese gjenden ne kasetat e sigurise, kur ka arsye te bazuara per te menduar se ato kane lidhje me vepren penale, edhe kur nuk i perkasin te pandehurit ose kur nuk jane ne emer te tij. Ne raste te ngutshme ky vendim mund te merret nga prokurori.

### **Nenin 36 te Kodit Penal:**

#### **Konfiskimi i mjeteve te kryerjes se vepres penale dhe produkteve te vepres penale:**

1.Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka te beje me marrjen dhe kalimin ne favor te shtetit:

a) te sendeve qe kane sherbyer ose jane caktuar si mjete per kryerjen e vepres penale;b)te produkteve te vepres penale, ku perfshihet cdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore qe vertetojne tituj ose interesa te tjere ne pasurine qe rrjedh ose fitohet drejtperdrejt ose terthorazi nga kryerja e vepres penale;c) te shperblimeve, te dhena ose te premtuara, per kryerjen e vepres penale;...

2.Nese produktet e vepres penale jane transformuar ose shnderruar pjeserisht: ose plotesisht ne pasuri te tjera, keto te fundit i nenshtroben konfiskimit.

3.Nese produktet e vepres penale jane bashkuar me pasuri te fituara ne rruqe te ligjshme, keto te fundit konfiskohen deri ne vleren e produkteve te vepres penale.

4.Konfiskimit i nenshtrohen edhe te ardhurat ose perfitimet e tjera nga produktet e vepres penale, nga pasurite ne te cilat jane transformuar ose shnderruar produktet e vepres penale ose nga pasurite me te cilat jane perzier keto produkte.

Gjykata cmon se me ane te kerkeses object gjykimi,organi procedues,vertetoi se ekziston dyshimi apo ka arsye te bazuara per te dyshuar se te ardhurat e gjeneruara ne llogarine bankare ne Tirana Bank,ne emer te shtetases F. P. kane lidhje me vepren penale, pavaresisht se nuk i perkasin te pandehurit ose nuk jane ne emer te tij (neni 210 I K.P.P.),per keto arsye:

- Shtetasja F. P. nder vite ka kryer depozitime ne para fizike ne vlera te konsiderueshme, burimi I te cilave duket I dyshimte dhe I pajustificuar;
- Ne llogari te saj jane kryer derdhje edhe nga shtetasi D. H., I cili ka dyshime se ka kryer veprimtari kriminale nga ato qe gjenerojne te ardhura te paligjshme;
- Nga te dhenat paraprake nuk rezultojne te dhena per aktivitete te ligjshem te ketyre shtetasve ne territorin shqipetar, nderkohe qe nga kqyrja e sistemit "Tims" rezulton se ata kane shume hyrje dalje.
- Shtetasi D. H. ka ndryshuar gjeneralitetet, fakt qe shton dyshimet se ai eshte marre me veprimtari kriminale.

- Shtetasi D. H., kryen veprime bankare ne llogarine e shtetases F. P., nderkohe qe per kete te fundit ky shtetas eshte ndaluar per vepren penale te "Trafikimit te femrave per prostitucion", mbi kallzimin e shtetases F. P..
- Shtetasja F. P. ka kerkuar transferimin ne Hollande te shumes 75 000 euro per blerje apartamenti, fakt qe tregon se pasuria e kesaj shtetaseje eshte shume e madhe.

Ne keto kushte kjo gjykate e gjen kerkesen e prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane te bazuar ne parashikimet e neneve 210, 274/ te Kodit te Procedures penale dhe 36 te Kodit Penal, e per rrjedhoje e pranon ate rregullisht:

### **P. K. A.**

Gjykata ne baze te nenit 210,274 te K.Pr.Penale

### **VENDOSI**

1. Pranimin e kerkeses.
1. Sekuestrimin e parave te ndodhuara ne llogarite bankare te F. N. P.e datelindjes 02.06.19.., lindur ne Shkoder dhe banuese ne Tirane, e dyshuar per kryerjen e vepres penale "Pastrim i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale" e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe vendosjen e sekuestros te llogarive prane "Tirana Bank", "Banka Kombetare Tregtare", "Raiffeisen Bank" dhe "Alpha".
1. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tirane, brenda dhjetë ditëve nga dhënia e vendimit ose nga dita që i interesuari ka marrë dijeni për sekuestron e vënë.

**U shpall ne Tirane me dt.12.03.2017.**

**SEKRETARE**  
**BLERINA ORUÇI**

**GJYQTARE**  
**FATIME DECOLLI**

